

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**Festa Shabani**

**NDËRRIMI I KODIT GJUHËSOR TE NXËNËSIT**  
**BILINGË SHQIPTARË: STUDIM RASTI I SHKOLLAVE**

**NDËRKOMBËTARE TË PRISHTINËS**

**PUNIMI I DOKTORATËS**

**Mentori i parë: Prof. dr. Milote Sadiku**

**Mentori i dytë: Prof. dr. Shkumbin Munishi**

**Prishtinë, 2023**

**Rezyme**

Ky punim mëton të investigojë gjuhën e folur nga nxënësit shqiptarë dygjuhësh në mjediset e shkollave ndërkombëtare të Prishtinës. Si rrjedhojë e kontaktit të përditshëm me më shumë se një gjuhë paraqiten dukuri bilinguale te folësit, si ndërrimi i kodit gjuhësor gjatë bisedës, përdorimi i huazimeve leksikore, kalket apo përkthimet e drejtpërdrejta të shprehjeve nga gjuha e dytë në gjuhën amtare apo anasjelltas, e të tjera. Për qëllimet e këtij studimi sinkronik, ndërrimi i kodit gjuhësor do të trajtohet më në detaje. Ky hulumtim mbështetet në hipotezën se bilingët shpesh do të kalojnë nga njëra gjuhë në tjetrën për të arritur qëllime të caktuara në bisedë gjatë të folurit të tyre. Kjo bëhet për faktin se gjuha e mësimin në shkollë është anglishtja dhe çdo temë që lidhet me gjuhën në të cilën ata janë ekspozuar do t'i nxisë ata ta përdorin këtë të fundit. Edhe pse vërehet ndikim i anglishtes në gjuhën shqipe, kjo e fundit vazhdon të jetë gjuha bazë dhe më dominuese te nxënësit shqipfolës në këto shkolla. Prandaj, kjo kërkon vëmendje të veçantë në përpjekje për të

identifikuar se në çfarë mase praktikohet ndërrimi i kodit gjuhësor në mesin e nxënësve bilingë shqiptarë.

Duke iu referuar një numri studimesh tashmë të bëra në këtë fushë, në këtë punim disertacioni është bërë përpjekje për të testuar vlefshmërinë empirike të disa prej qasjeve/modeleve më të spikatura për analizë të ndërrimit të kodit gjuhësor, kryesisht në rrafshin strukturor dhe funksional. Në këndvështrimin strukturor, në radhë të parë për të verifikuar cila nga gjuhët në dispozicion të folësve mbetet gjuha matricë, çfarë e përbën një fjali me ndërrim kodi – cilat gjymtyrë të fjalisë futen në gjuhën bazë nga gjuha e dytë dhe si kombinohen përbërësit e dy gjuhëve brenda një fjalie të vetme. Në pikëvështrimin funksional, do të bëhet përpjekje për të identifikuar arsyet e përdorimit të njërës gjuhë apo gjuhës tjetër përmes identifikimit të modeleve të folurit të tyre, në këtë mënyrë perspektivat që kanë gjetur aplikueshmëri në dyshe gjuhësh në kontakt do të merren parasysh kur analizohen motivet prapa përzgjedhjes së tyre gjuhësore.

Në këtë punim disertacioni përdoren metoda kualitative për mbledhjen e të dhënave, si observimi sistematik i nxënësve, grupet e fokusit, si dhe intervista në grup. Poende, analiza kuantitative u aplikua gjithashtu te analiza e përmbajtjes së korpusit. Fillimisht, u përcaktua mbizotërimi statistikor i gjuhëve pjesëmarrëse në bisedë, pastaj testi *hi në katror* u aplikua për të determinuar rëndësinë e faktorëve ekstralinguistikë në përdorimin e njërës gjuhë kundruall tjetrës, por edhe në llojin e ndërrimit të kodit gjuhësor. Vëzhgimi sistematik i pjesëmarrësve kishte për qëllim të nxjerrë në pah gjuhë sa më të natyrshme duke qenë se nxënësit u vëzhguan në mjedise joformale brenda shkollave, si gjatë kohës së drekës, pushimit të gjatë i cili zhvillohej kryesisht në ambient të jashtëm, ata u vëzhguan gjersa luanin në sheshin e lojërave, gjatë orës së edukatës fizike, etj., ku ishim vëzhgues (bystanders) dhe nuk merrnim pjesë në bisedat e tyre. Së këndejmi, grupet e fokusit u organizuan me qëllim që të shihet nëse ka dallim përzgjedhja gjuhësore në komunikimin e nxënësve me persona të jashtëm siç ishim ne, pra për të parë nëse një faktor i tillë si pjesëmarrja jonë në bisedë ndikon në përzgjedhjen e gjuhës; dhe intervistat për të marrë informacione të rëndësishme për ta, si për sfodin e tyre gjuhësor, qëndrimet e tyre kundrejt gjuhëve që flasin, për secilin nga pjesëmarrësit veç e veç, u regjistruan vetraportimet dhe këndvështrimet e nxënësve rreth shkallës së njohjes së gjuhëve respektive, shqipes dhe anglishtes, si dhe arsyeve të përdorimit të gjuhës dhe zgjedhjes së kodit në kontekste të ndryshme.

Analiza e këtij studimi sinkronik bazohet në një korpus prej 16 orësh e tetë minutash, ku u gjeneruan 931 raste me ndërrime kodi. Në parim u vërtetua hipoteza e parë se ndërrimi i kodit

gjuhësor shfaqet të jetë dukuri e zakonshme bilinguale te këta nxënës brenda shkollave ndërkombëtare të Prishtinës. Por, kjo varion sipas moshës së nxënësve dhe moshës së përvetësimit të gjuhës angleze, siç u vërtetua përmes analizave statistikore. Gjuha shqipe është gjuha dominuese apo gjuha matricë në diskurs brenda së cilës ka insertime nga anglishtja. Pra, ndërrimi i kodit gjuhësor është njëdrejtimësh dhe ka asimetri në pjesëmarrje të gjuhëve. Në bazë të sjelljes së tyre gjuhësore, nxënësit u ndanë në dy grupe: grupi i parë përbën nxënësit e klasës së pestë të moshës 9-10 vjeç dhe nxënësit e shkollës së mesme të ulët të moshës 11-14 vjeç. Nxënësit që e përvetësuan anglishten në moshë më të hershme i përkasin grupit të parë dhe e fusin në përdorim anglishten në masë më të madhe se gjuhën shqipe në bisedat e tyre, por ndërrimin e kodit gjuhësor e kanë në kufij të fjalive, pra preferojnë t'i mbajnë gjuhët e ndara. Ndërsa nxënësit të cilët e përvetësuan anglishten më vonë i përkasin grupit të dytë në hulumtimin tonë dhe janë dy grupe që variojnë nga mosha 15-19 vjeç. Ndërrimi i kodit gjuhësor te këta nxënës është i tipit intrasentencial, apo në nivel të fjalisë ku shqipja e përcakton kornizën sintaksore të fjalisë brenda së cilës ka insertime me fjalë, sintagma, madje edhe fjali nga anglishtja. Në analizën strukturore të fjalive me ndërrim kodi qëllimi ishte të vlerësohen të dhënat e marra kundrejt dy modeleve me ndikim të gramatikës së ndërrimit të kodeve, përkatësisht *Korniza Gjuhësore Matricë* e Myers-Scotton dhe modeli i propozuar nga MacSwan në kuadër të *Programit Minimalist* të Chomsky. Rezultatet tregojnë se të dhënat nga dyshja shqip/anglisht mund të shpjegohen vetëm pjesërisht nga qasjet MLF dhe MP. CS është kryesisht njëdrejtimësh me insertime nga anglishtja në një kornizë sintaksore të shqipes. Determimerët, si përemrat dëftorë, përemrat e pacaktuar, ndajfoljet e sasisë, foljet këpujore, foljet ndihmëse, nyjet, dhe klitikët vijnë nga gjuha matricë (ML), në përputhje me modelin MLF. Gjithsesi, hasen edhe shkelje të modelit MLF, si mosshfaqja e CS-së ndërmjet stemit dhe afiksit, insertimi i formave të zhveshura, ishujt EL që jo gjithmonë përbëjnë projeksionin maksimal të sintagmës, të cilat përshkruhen dhe parashikohen më tej në modelin MP. Ky hulumtim ofron dëshmi se as MLF dhe as MP nuk mund të shpjegojnë në mënyrë adekuate kombinimet e mundshme në fjalinë e përzier.

Pas analizës së plotë të rasteve me ndërrime kodi në korpusin tonë implikohet se ndërrimi i kodit gjuhësor ndërlidhet me përvetësimin e gjuhës, ku së pari përvetësohen morfemat përmbajtësore (content morphemes) pastaj morfemat funksionale/gramatikore (system morphemes), pasi insertimet nga anglishtja në fjalinë shqipe janë kryesisht fjalë përmbajtësore. Poashtu, mosinsertimin e morfemave funksionale nga anglishtja në strukturën sintaksore të shqipes

mund ta shpjegojme duke u bazuar te MacSwan dhe teorema e tij nga programi minimalist, se në një fjali me ndërrime kodi, fjalët funksionale kanë më shumë gjasa të vijnë nga gjuha që kodon numrin më të madh të veçorive të paiterpretueshme në atë fjalë të caktuar. Si veçori të paiterpretueshme konsiderohen aspektet e fjalës që janë tipike sintaksore si rasa, gjinia, numri, veta, përshtatja. Në këtë rast gjuha shqipe si gjuhë me fleksion të lartë ka veçori të tilla që dominojnë krahas anglishtes në një fjali të përzier, andaj edhe gjen mbështetje në këtë pikë.

Duke qenë se kufizimet gramatikore të sugjeruara në literaturë janë shumë përshkruese dhe kanë kufizime metodologjike, kemi arritur në përfundim se ndërrimi i kodit gjuhësor nuk mund të shpjegohet me një teori të vetme. Jo rëndom, kjo ndërlidhet me atë që tregon literatura e deritanishme se analizimi i ndërrimit të kodeve përmes integritit të qasjeve të ndryshme teorike njëkohësisht ndihmon në të kuptuarit më të mirë të gramatikës së ndërrimit të kodeve.

Në këtë studim për kuptimin e arsyeve të ndërrimit të kodit gjuhësor jemi mbështetur te Analiza e Bisedës (Conversation Analysis) që vihet në përdorim nga Peter Auer (1984, 1995, 1998, 2005, 2020), në mënyrë që të gjenerohen modelet e bisedave me ndërrime kodi dhe të interpretohen ato. Pas analizës së detajuar përshkruese të bisedave rresht për rresht, mund të thuhet se ndërrimi i kodit lidhet me diskursin ose me personin apo preferencën. Lidhur me funksionet e diskursit, rezultatet tregojnë se CS lidhet me diskursin por edhe me pjesëmarrësit ose preferencat gjuhësore. Ndërrimi i kodit nuk lidhet vetëm me ndërrimin e temës së bisedës, por ai shërben një sërë funksionesh të tjera ligjërimit, të tilla si ndërrimi i konstelacionit të pjesëmarrësve në bisedë, si përzgjedhja e të adresuarit, përfshirja ose mospërfshirja e pjesëmarrësve në bisedë, përshtatja e zgjedhjes së gjuhës nga bashkëfolësi, theksimi i ligjëratës së drejtë, komentet sekondare, përkthimet për emfazë, përsëritjet, loja me gjuhën, ndërrimi i mënyrës/tonalitetit të bisedës, topikalizimi, plotësimi i boshllëkut leksikor, etj. Të dyja gjuhët përdoren gjatë organizimit të lojës, kur konkurrojnë për marrjen e fjalës, kur tregojnë emocionet e tyre, kur flasin për bashkëmoshatarët, etj. Sidoqoftë ka edhe ndërrime kodi të shfaqura te pjesëmarrësit të cilat janë në dukje të panxitura. Pra, midis grupmoshave të ndryshme të hulumtuara në studimin tonë, CS si shenjë kontekstualizuese shfaqet të ketë një sërë funksionesh.

Si përfundim, studimet e këtij lloji japin kontribut të rëndësishëm në sociolinguistikë në përgjithësi, me fokus në anglishten dhe shqipen në veçanti (duke qenë se këto të dyja janë në kontakt më intensiv dhe të drejtpërdrejtë gjatë 20 viteve të fundit), si dhe në studimin e kontakteve gjuhësore dhe të dygjuhësisë në veçanti. Së kendejmi, studimi në fjalë është një kontribut origjinal

i punës në terren (vëzhgim sistematik i nxënësve duke sjellë gjuhën origjinale spontane të folur në ambientet informale brenda kampusit të shkollave ndërkombëtare të Prishtinës, ku nxënësit nuk janë nën presion të përzgjedhjes së njërës gjuhë apo tjetrës), mbështetur dhe punuar mbi bazën e literaturës më aktuale dhe më të diskutuar mbi ndërrimin e kodeve. Hulumtimi në fjalë kontribuon në diskutimet e vazhdueshme në këtë fushë duke dhënë shembuj konkretë të fjalive të përziera me glosa interlineare, ku edhe u argumentuan kundërshembuj të modeleve të propozuara për analizë të CS-së nga një mjedis për të cilin dihet relativisht pak.

*Fjalët kyçe: Kontaktet gjuhësore, bilinguizmi, code-switching-u, shqipja, anglishtja*

## **Resume**

This research aims at investigating the language spoken by Albanian bilingual students within the settings of international schools in Prishtina. The use of code-switching, lexical borrowings, and calques, also known as direct translations of expressions from the second language to the mother tongue or vice versa, are some examples of the bilingual phenomena that arise in speakers as a result of everyday contact with more than one language. For the purposes of this synchronic study, code-switching is examined in more detail. This research is based on the hypothesis that bilinguals will often switch from one language to another to achieve certain conversational goals during their speech. This is due to the fact that the language of instruction at school is English and any topic related to the language they are exposed to will trigger them to use the English language. Even though there is an influence of English on the Albanian language, the latter continues to be the matrix and the more dominant language in conversations among Albanian-speaking students in these schools who continue their education in English. Therefore, it is important to pay close attention to this in order to determine how frequently Albanian bilingual students practice code-switching.

In this dissertation work, an effort has been made to assess the empirical validity of some of the most popular approaches/models for the analysis of code-switching, primarily from a structural and functional point of view, by making reference to a number of previous studies in the field. From the structural point of view, in the first place, this research is aimed at verifying which of the languages available to the speakers remains the matrix language, what constitutes a code-switched clause, i.e. which constituents are switched, and in what ways the components are combined within a single mixed clause. In order to analyze the factors that triggered students to choose one language over another, there will be an attempt to identify their speech patterns from a functional point of view. In so doing, the viewpoints that have proven useful in language contact pairs will be taken into consideration.

For the purposes of this dissertation, qualitative methods are used for data collection, such as systematic observation of students, focus groups, and group interviews. However, quantitative analysis was also applied to corpus content analysis. First, the statistical preponderance of the words in each language participating in the conversation was determined, then the chi-square test was applied to determine the importance of extralinguistic factors in the use of one language versus the other, but also in the type of code-switching. The systematic observation of the participants

aimed to highlight the most natural language as the students were observed in informal settings within the school, such as during lunchtime, and during recess time which took place mainly outside. They were observed while on the playground, during physical education classes, etc., where we were bystanders and did not participate in their conversations. Then, focus groups were organized in order to see if there is a difference in language choice in students' communication with outsiders like us. That is, to see if a factor such as our participation in the conversation affects language choice; and the interviews were conducted to obtain important information for them, such as their linguistic background, their attitudes towards the languages they speak, for each of the participants separately was taken, self-reports and perspectives of the students about the level of knowledge of the respective languages, namely Albanian and English, were recorded, as well as the reasons behind their language use and code choice in different contexts were examined.

The analysis of this synchronic study is based on a corpus of 16 hours and eight minutes, which generated 931 cases of code-switching. In principle, the first hypothesis was confirmed that code-switching seems to be a common bilingual phenomenon among the students within the international schools of Prishtina. But this varies with age and age of English language acquisition, as proven by statistical analysis. The Albanian language is the more dominant language or matrix language in the discourse within which there are insertions from English. So code-switching is unidirectional and there is an asymmetry in the participation of the languages involved in code-switching. Based on their language behavior, the students were divided into two groups: the first group consists of fifth-grade students aged 9-10 and middle school students aged 11-14. The students who acquired English at an earlier age belong to this group and seem to incorporate English to a greater extent than the Albanian language in their conversations, but they code-switch intersententially. So they prefer to keep their languages separate. While students who acquired English later belong to the second group in our research, and there are two groups ranging from 15-19 years of age. The aim of the structural analysis of code-switched sentences was to assess the data against two influential theories of code-switching grammar, specifically the model put forth by MacSwan within Chomsky's Minimalist Program and Myers-Matrix Scotton's Matrix Language Framework. The findings indicate that the MLF and MP methods can only partially account for the data from the Albanian/English pair. CS is mainly unidirectional, with insertions from English into an Albanian syntactic framework. Determiners, such as demonstrative pronouns, indefinite pronouns, adverbs of quantity, copulative verbs, auxiliary verbs, articles, and clitics

come from the matrix language (ML), complying with the MLF model. However, there are also violations of the MLF model, such as the non-occurrence of stem/ affix CS, the insertion of bare forms, EL islands that do not always constitute the maximum projection of the phrase, which are further described and predicted in the MP model. This research provides evidence that neither MLF nor MP can adequately explain the possible combinations in the mixed sentence.

One implication from a detailed investigation is that code-switching is related to language acquisition, where content morphemes are acquired first and then functional ones. This is because the insertions from English into the Albanian sentence are mainly content words. In addition, it is given in MacSwan's theorem within Minimalist Program why functional morphemes from English did not enter the syntactic structure of the Albanian language. He claims that functional words are more likely to come from the language that encodes the largest number of uninterpretable features, such as case, gender, number, person, and agreement. As a highly inflected language, Albanian is supported in this case because it has features that outweigh those of English in a mixed sentence.

We have come to the conclusion that there is no single approach that can account for code switching because the grammatical constraints proposed in the literature are overly descriptive and have methodological limitations. This is related to what the literature to date indicates that the integrating the approaches rather than using each one separately contributes to a better understanding of the grammar of code-switching.

We generated conversation patterns and interpreted them using Peter Auer's Conversation Analysis (1984, 1995, 1998, 2005, 2020) in order to comprehend the reasons for code-switching in conversation. Upon thorough descriptive examination of turn-by-turn analysis of language choices, one can conclude that code-switching is either related to discourse, people, or their preferences. Students were found to code-switch not only when changing the topic of the conversation but it serves a range of discourse functions, such as when changing participant constellation (e.g., addressee selection, such as inclusion or exclusion of participants from the conversation); for emphasizing direct speech; for secondary or side comments; when translating for emphasis; repetition; language play; when changing the mode or tone of the conversation, topicalization, filling lexical gaps. Both languages are used when organizing the game, when competing for taking turns, when they show their emotions, when they talk about their peers, etc. There were also instances where speakers code-switched without any apparent reason. Hence that



seems to occur unintentionally. Thus, CS as a contextualization cue serves a range of discourse functions among the various age groups examined in our study.

Studies of this kind make significant contributions to sociolinguistics in general, with a focus on English and Albanian in particular (owing to the fact that these two have been in more intense and direct contact over the past 20 years or so), as well as to the studies of language contacts and bilingualism in particular. Additionally, the study at hand is a first-of-its-kind contribution of fieldwork (systematic observation of students using original spontaneous language spoken in informal settings on the campuses of international schools in Prishtina, when there is no pressure on students to select one language over another) that relied and worked on the basis of the most recent and widely-discussed literature on code-switching. By offering specific examples of mixed clauses with interlinear glosses, the study adds to ongoing discussions in the field. In these instances, counter-examples of suggested models for the analysis of code-switching were also made from a setting where relatively little is known.

*Keywords: Language contacts, bilingualism, code-switching, Albanian, English*

